



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Kryesuese e Senatit
Prof.asoc.dr. Merita Shala

Nr. Prot. 2992 Dt 21.12.2023

Senati i Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 19.12.2023, mori:

VENDIM

- I. Anulohet pjesërisht konkursi me nr.prot.2067 i publikuar me dt.10.10.2023 dhe njoftimi mbi plotësim konkursi me nr.prot.2097 publikuar me dt.11.10.2023 për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për vitin akademik 2023/2024
- II. Anulimi i konkursit të shpallur më dt.10.10.2023 dhe njoftimi mbi plotësim konkursi publikuar me dt.11.10.2023 do të bëhet për këto pozita:

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

1. Një mësimdhënës për lëndët: Matematika I dhe Matematika II.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

1. Një mësimdhënës për lëndët: Zhvillimi i aplikacioneve mobile, Siguria e informacionit, Web programimi, për shkak se askush nuk i plotëson kriteret.

Fakulteti Juridik

1. Një asistent për lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta administrative, E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese krahasuese, Procedura administrative, E drejta e punës.

Fakulteti i Edukimit

1. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe III (Sintaksa) me metodologji, Metodologji e gjuhës shqipe.
 2. Një mësimdhënës për lëndën: TIK në arsimin Fillor.
 3. Një asistent për lëndët: Bazat e edukimit muzikor, Bazat e arsimit muzikor, Interpretim me instrumente.
 4. Një asistent për lëndët: Gjuhë shqipe III (Sintaksa) me metodologji, Metodologji e gjuhës shqipe.
 5. Një asistent për lëndën: TIK në arsimin Fillor.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitat nga pika II bëhet për arsye se:

Në **Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore**, për pozitën Një mësimdhënës për lëndët: Matematika I dhe Matematika II, kandidati nuk i plotëson kriteret në bazë të nenit 171 pika 4, pastaj nenit 7 pika 2.1 dhe pika 2.2 të Rregullores nr. 1670, dt. 28.09.2021.

Në **Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike**, për pozitën “Një mësimdhënës për lëndët: Zhvillimi i aplikacioneve mobile, Siguria e informacionit, Web programimi”, kandidati nuk i plotëson kriteret në bazë të nenit 171 pika 4, pastaj nenit 7 pika 2.1 dhe pika 2.2 të Rregullores nr. 1670, dt. 28.09.2021.

Në **Fakultetin Juridik**, për pozitën “Një asistent për lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta administrative, E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese krahasuese, Procedura administrative, E drejta e punës”, për shkak të shkeljes së afateve të përcaktuara me Rregulloren 1670 dt. 28.09.2021, neni 8 pika 1.

Në **Fakultetin e Edukimit**, për pozitën Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe III (Sintaksa) me metodologji, Metodologji e gjuhës shqipe, kandidatet nuk kanë prezentuar dokumentacion të kompletuar i kërkuar sipas konkursit 2067 dt.10.10.2023;

Ndërsa për pozitën “Një mësimdhënës për lëndën: TIK në arsimin Fillor” nuk ka pasur kandidatë të interesuar për këtë pozitë.

Për pozitën “Një asistent për lëndët: Bazat e edukimit muzikor, Bazat e arsimit muzikor, Interpretim me instrumente”, nuk ka pasur kandidatë të interesuar për këtë pozitë.

Për pozitën “Një asistent për lëndët: Gjuhë shqipe III (Sintaksa) me metodologji, Metodologji e gjuhës shqipe”, nuk ka pasur kandidatë të interesuar për këtë pozitë.

Për pozitën “Një asistent për lëndën: TIK në arsimin Fillor”, për shkak të shkeljes së procedurës administrative dhe afateve të përcaktuara me Rregulloren 1670 dt. 28.09.2021.

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t’i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrës për informim me publikun

Prof.asoc.dr.Merita Shala

Kryesuese e Senatit

